



AUTORITETI KOSOVAR I KONKURENCËS  
AUTORITET KOSOVA ZA KONKURENCIJU  
KOSOVO COMPETITION AUTHORITY

# PROGRAMI I LEHTËSIMIT I KONKURENCËS

SIGURIMI I PËRFITIMEVE NGA  
KONKURRENCA E DREJTË

# 8





**Autoriteti Kosovar i Konkurrencës**  
**Autoritet Kosova za Konkurenciju**  
Kosovo Competition Authority

**SIGURIMI I PËRFITIMEVE NGA  
KONKURRENCA E DREJTË (Broshura Nr.8)**

# **PROGRAMI I LEHTËSIMIT I KONKURRENCËS**



Sipas Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës (të ndryshuar)<sup>1</sup>, ka hapësirë për zbatimin e gjobave të konsiderueshme për shkelje serioze të rregullave të konkurrencës bazuar në vendimet e Komisionit Kosovar të Konkurrencës<sup>2</sup> dhe të Autoritetit Kosovar të Konkurrencës<sup>3</sup>.

Në rastet e shkeljeve të madha të rregullave të konkurrencës, mund të shqiptohen gjoba deri në 10% të qarkullimit më të fundit vjetor të një ndërmarrjeje, që do të thotë se është një shkelje rëndë e Ligjit. Në rastet kur ajo ndërmarrje është pjesë e një grupi më të gjerë ndërmarrjesh gjithashtu të përfshira në shkelje, për qëllimet e caktimit të gjobës mund të përdoret qarkullimi më i fundit vjetor i grupit në fjalë.

Shkeljet më të rënda të Ligjit kanë të bëjnë me: pjesëmarrjen në një kartel, të qenit palë në një marrëveshje të ndaluar, zbatimin e një përqendrimi të ndaluar dhe abuzimin me një pozitë dominuese në treg në Kosovës<sup>4</sup>. Gjithashtu parashikohen gjobat më të vogla në raste të tilla si mosdhënia e informacionit të kërkuar nga Autoriteti ose dhënia e informacionit të rremë ose mashtrues<sup>5</sup>. Gjobat llogariten sipas rastit dhe marrin parasysh, sidomos, rrethanat rënduese ose rrethanat lehtësuese të rëndësishme për shkeljen<sup>6</sup>.

### ***Kundërpërgjigja ndaj karteleve të forta***

Shkeljet më të rënda të rregullave të konkurrencës (jo vetëm në Kosovë, por në të gjithë botën) kanë të bëjnë me funksionimin e atyre që njihen si "kartele të forta". Kartelet janë forma më e rëndë e sjelljeve anti-konkurrese ndërmjet konkurrentëve

---

<sup>1</sup> Ligji për Mbrojtjen e Konkurrencës (Nr. 03 / L-220) i vitit 2010 i ndryshuar me Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës (Nr. 04 / L-226) të vitit 2014.

<sup>2</sup> Ligji për Mbrojtjen e Konkurrencës (i ndryshuar), Neni 28

<sup>3</sup> Ligji për Mbrojtjen e Konkurrencës (i ndryshuar), Neni 54.

<sup>4</sup> Ligji për Mbrojtjen e Konkurrencës (i ndryshuar), Neni 56.

<sup>5</sup> Ligji për Mbrojtjen e Konkurrencës (i ndryshuar), Neni 57.

<sup>6</sup> Këto konsiderata trajtohen në Nenet 59 dhe 60 të Ligjit dhe metodologjia për caktimin e gjobave është elaboruar më tej në Udhëzimin Administrativ Nr. 1/2018 të Autoritetit për kriteret për vendosjen e masave të sanksionit administrativ.

sepse ato përfshijnë një përpjekje të qëllimshme për të destabilizuar tregun dhe për të penguar konkurrencën. Termi kartel zakonisht përdoret për të përshkruar çdo shoqatë ose rregullim informal që përfshin dy ose më shumë ndërmarrje konkurruese. Në një kartel, anëtarët diskutojnë dhe shkëmbejnë informacione në lidhje me bizneset e tyre ose arrijnë marrëveshje në lidhje me sjelljen e tyre në të ardhmen duke synuar kufizimin e konkurrencën midis tyre dhe për të rritur çmimet ose përfitimin e tyre.

Në praktikë, një kartel është një grup i ndërmarrjeve të ngjashme, të pavarura që bashkohen së bashku për të rregulluar çmimet, për të kufizuar prodhimin ose për të ndarë tregjet apo klientët ndërmjet tyre. Për të bashkërenduar veprimet e tyre ose për të vendosur një marrëveshje firmat duhet të komunikojnë ndërmjet tyre. Kështu që në vend që të konkurrojnë me njëri-tjetrin, anëtarët e kartelit mbështeten në veprimin e rënë dakord të njëri-tjetrit, i cili zvogëlon stimujt e tyre për të siguruar produkte dhe shërbime të reja apo më të mira dhe çmime më konkurruese. Si pasojë, konsumatorët e tyre ose bizneset e tjera përfundojnë duke paguar më shumë për më pak cilësi. Kartelet zakonisht bëhen fshehurazi dhe në mënyrë të pashmangshme kanë të bëjnë me një ose më shumë nga kufizimet "thelbësore" të ligjit të konkurrencës: caktimin e çmimeve, manipulimin më oferta (tender i fshehtë), vendosjen e kufizimeve në prodhim ose kuota dhe/ose ndarjen e tregut. Prandaj, pothuajse me siguri, do të zbulohet se ato kanë një efekt negativ në konkurrencë dhe që nuk kanë përfitim në kompensues. Prandaj, veprimet e një karteli do të jenë gjithmonë të paligjshme sipas Ligjit dhe nuk do të përmbushin kriteret për ndonjë përjashtim.

Sidoqoftë, kartelet nga natyra e tyre janë shumë sekrete dhe, për këtë arsye, janë të vështira për t'u zbuluar dhe provuar si çështje ligjore. Prandaj, nevojiten rregullime të veçanta për të lehtësuar zbatimin e Ligjit në lidhje me kartelet e forta.

## Origjina e programeve të faljes lidhur me shkeljet e rënda të konkurrencës

Në Shtetet e Bashkuara, programi fillestar i faljeve për trajtimin karteleve të forta daton që nga viti 1978. Sidoqoftë, vetëm pasi Divizioni Anti-trust i Departamentit të Drejtësisë të SH.B.A.-së rishikoi "Programin e Lehtësimeve për Korporatat" në 1993, programi i lehtësimeve së SHBA u bë plotësisht i suksesshëm dhe është bërë mjeti më efektiv i hetimit i Divizionit Anti-trust.

Suksesi i programit të lehtësimeve/faljeve të SH.B.A.-së në vitin 1993 çoi në miratimin e programeve të ngjashme për deklarim/zbulim vullnetar nga juridiksione të tjera dhe pasi u arritën përmirësime thelbësore në Kanada dhe BE pas vitit 2000, programet e faljeve/lehtësirave për korporatat e Shteteve të Bashkuara, të Bashkimit Evropian dhe Kanadasë erdhën me harmonizime thelbësore, çka e ka bërë shumë më të lehtë dhe shumë më tërheqëse që përnjëherësh kompanitë të kërkojnë dhe të përfitojnë nga faljet/lehtësirat në Shtetet e Bashkuara, Evropë, Kanada dhe në një listë në rritje të juridiksioneve të tjera ku aplikuesit janë të ekspozuar.

Që nga viti 2000, BE-ja ka reformuar qasjen e saj tradicionale ndaj marrëveshjeve kufizuese dhe praktikave të karteleve duke hequr kërkesat për njoftimit të detyrueshëm të marrëveshjeve, duke deleguar gjithnjë e më shumë zbatimin e rregullave të BE-së për konkurrencën tek autoritetet e konkurrencës të Shteteve Anëtare të BE-së (të cilat tani zakonisht përdorin rregullat e Traktatit të BE-së për konkurrencën si bazë për ligjet dhe politikat e tyre kombëtare të konkurrencës<sup>7</sup>) dhe forcimin e kompetencave hetimore të Komisionit Evropian në lidhje me hetimet e kartelit me anë të një departamenti për zbatim të rregullave në lidhje me kartelet, të një programi lehtësirash (për

---

<sup>7</sup> Veçanërisht, nenet 101 dhe 102 të Traktatit për Funkcionimin e Bashkimit Evropian.

disa anëtarë të kartelit që shpalosin informacionin ) dhe mbrojtje të përmirësuar të ankuesve p.sh. kur ata janë punonjës të një kompanie të kartelit.

Këto reforma në sistemin e BE-së bëjnë që të pranohet fakti se kartelet janë prioriteti më i lartë në zbatimin e ligjit në nivel të BE-së dhe se ato vazhdojnë të ekzistojnë dhe të shkaktojnë dëme në konkurrencë në kurriz të tregjeve dhe konsumatorëve. Sjelljet e karteleve janë të paligjshme sipas ligjit të BE-së dhe në bazën e idesë së përfitimeve pozitive nga tregjet e hapura dhe konkurruese Komisioni Evropian ka vendosur gjoba gjithnjë e më të rënda për kompanitë e përfshira në një kartel. Gjoba në lartësinë deri në 10% të qarkullimit të tyre në mbarë botën mund të vendosen ndaj palëve fajtoresh në procedurat e kartelit të BE-së në kuadër të Traktatit për Funkcionimin e Bashkimit Evropian.

Në pesë vitet e fundit, Komisioni Evropian ka vendosur gjoba në total me 16.3 miliardë € në raste të ndryshme kartelesh.

#### ***Disa raste Karteli në BE kohëve të fundit***

- Komisioni gjosit blerësit e etilenit me 260 milion € në zgjidhjen e kartelit (korrik 2020).
- Komisioni gjosit Coroos dhe Groupe CECAB me 31.6 milion € për pjesëmarrje në kartelin e perimeve të konservuara (shtator 2019).
- Komisioni gjosit pesë prodhues të shufrave të çelikut përforcues me 16 milion € për kartelin për fiksimin e çmimeve (korrik 2019).
- Komisioni gjosit Barclays, RBS, Citigroup, JPMorgan dhe MUFG me 1.07 miliardë € për pjesëmarrjen në kartelin e tregtimit të këmbimit valutor (maj 2019).

Për shkak se nga natyra e tyre kartelet janë, marrëveshje të fshehta, është përgjithësisht e vështirë të përcaktohet ekzistenca e tyre në mungesë të provave të forta (në ligjin e konkurrencës të njohura shpesh si "arma shkatërruese"). Për këtë arsye, politikat e BE-së për lehtësirat/faljet inkurajojnë pjesëmarrësit e kartelit që të prishin radhët me kartelin dhe të sigurojnë dëshmi nga brendësia e tij për Komisionin Evropian. Kompania e parë në çdo



kartel që e bën këtë nuk do t'i duhet të paguajë një gjobë. Kjo rezulton në destabilizimin e kartelit. Në vitet e fundit, shumica e karteleve janë zbuluar nga Komisioni Evropian pasi një anëtar i kartelit është rrëfyer dhe ka kërkuar lehtësira, megjithëse Komisioni Evropian gjithashtu vazhdon të kryejë hetimet e veta me sukses në zbulimin e karteleve.

Sipas njoftimit të Komisionit Evropian për Lirimin e vitit 2006<sup>8</sup>, një anëtar informues i kartelit mund të marrë imunitet total nga gjobat në një rast karteli ose një ulje të gjobave.

Në mënyrë që të fitohet imuniteti i plotë sipas politikës së faljeve/lehtësimeve të BE-së, një kompani e cila ka marrë pjesë në një kartel duhet të jetë e para që informon Komisionin për një kartel të pazbuluar duke siguruar informacion të mjaftueshëm për t'i mundësuar Komisionin të nisë një inspektim në ambientet e kompanive që dyshohet se është përfshirë në kartel. Nëse Komisioni tashmë posedon informacion të mjaftueshëm për të filluar një inspektim ose tashmë ka ndërmarrë një të tillë, kompania duhet të sigurojë prova që i mundësojnë Komisionit të dëshmojë shkeljen e kartelit. Në të gjitha rastet, kompania duhet gjithashtu të bashkëpunojë plotësisht me Komisionin gjatë gjithë procedurës së tij, t'i sigurojë atij të gjitha provat që ajo posedon e t'i japë fund shkeljes menjëherë. Bashkëpunimi me Komisionin nënkupton që ekzistenca dhe përmbajtja e aplikimit nuk mund të zbulohen për ndonjë kompani tjetër. Për më tepër, është e përcaktuar qartë që ndërmarrja mund të mos përfitojë nga imuniteti nëse ka ndërmarrë hapa për të detyruar ndërmarrjet e tjera të marrin pjesë në kartel. Kompanitë të cilat nuk kualifikohen për imunitet mund të përfitojnë një zbritje të gjobave nëse sigurojnë prova që përfaqësojnë "vlerë të shtuar të konsiderueshme" në krahasim me ato që zotëron Komisioni dhe nëse e kanë përfunduar pjesëmarrjen e tyre në kartel. Provat konsiderohet të jenë me një "vlerë të shtuar të konsiderueshme" për Komisionin kur përforcojnë mundësitë e tij për të provuar shkeljen. Kompania e parë që plotëson këto kushte i bëhet një zbritje prej 30 deri në

---

<sup>8</sup> Komisioni Evropian: Njoftim për imunitetin nga gjobat dhe uljen e gjobave në rastet e karteleve, OJ C 298 i 8 dhjetorit 2006.

50%, e dyta prej 20 deri në 30% dhe ndërmarrjeve pasuese deri në 20%.

Që nga viti 2008, kompanitë që janë zbuluar nga Komisioni duke marrë pjesë në një kartel mund të zgjidhin çështjen e tyre me rregullatorin e konkurrencës së BE-së duke pranuar përfshirjen e tyre në kartel dhe duke marrë një gjobë më të vogël në këmbim<sup>9</sup>. Sipas kësaj procedure, pasi kanë parë provat në dosjen e Komisionit, pjesëmarrësit në një kartel mund të zgjedhin të pranojnë përfshirjen e tyre në kartel dhe përgjegjësinë e tyre për këtë. Në këmbim të këtij pranimi fajësie, Komisioni mund ta zvogëlojë gjobën e vendosur ndaj palëve me 10%. Kjo procedurë e zgjidhjes u prezantua për të thjeshtuar procedurat administrative dhe hetimore dhe për të zvogëluar sasinë e çështjeve gjyqësore në Gjykatat Evropiane në çështjet e karteleve. Për nga shtrirja, komisioni vendosi të zvogëlojë gjithashtu kostot dhe vonesat në kohë.

Bashkëpunimi në procedurën e zgjidhjes është i ndryshëm nga sigurimi i provave vullnetarisht për të nxitur ose avancuar hetimin e Komisionit në kuadër të procedurës së faljeve/lehtësimeve, megjithëse, kur zbatohen të dyja - zvogëlimi i 'zgjidhjes' si dhe zvogëlimi nga lehtësimet - ato zbatohen në mënyrë kumulative.

Të gjitha vendimet në lidhje me kartelet ose të tjera të nxjerra nga Komisioni në lidhje me shkeljet e Traktatit mund të apelojnë, së pari, në Gjykatën e Përgjithshme të Bashkimit Evropian dhe pastaj në Gjykatën e Drejtësisë të Bashkimit Evropian. Prandaj, ato mund të shqyrtohen edhe më në detaje nga këto dy gjykata, të cilat janë të autorizuara të anulojnë vendimet në tërësi ose pjesërisht dhe të ulin ose të rrisin gjobat, kur kjo gjykohet e përshtatshme

Që nga viti 2006, mbi 50 juridiksione në të gjithë botën kanë futur programe të ngjashme faljesh/lehtësimesh.

---

<sup>9</sup> Komisioni Evropian: Rregullorja e Komisionit (KE) Nr. 622/2008 e 30 Qershorit 2008 që ndryshon Rregulloren (KE) Nr. 773/2004, në lidhje me zhvillimin e procedurave të zgjidhjes në çështjet e karteleve, OJ L 171 i 1 korrikut 2008

## **Programi i Faljeve/Lehtësimeve i Autoritetit Kosovar të Konkurrencës**

Programi i Faljeve/Lehtësimeve i AKK-së në lidhje me gjobat për shkelje të rënda të Ligjit përcaktohet me Nenin 60 të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës (të ndryshuar). Kjo parashikon që, me qëllim të zbulimit të shkeljeve serioze të Ligjit, Autoriteti mund të përjashtojë pjesëmarrësin e kartelit i cili informon i pari për ekzistencën e kartelit tek Autoriteti dhe i cili siguron të dhëna, fakte dhe prova që i mundësojnë Autoritetit të ndjekë në mënyrë efektive çështjen kundër kartelit. Në rastet kur Autoriteti tashmë e ka filluar procedurën e tij të hetimit por nuk ka fakte të mjaftueshme për ta përfunduar atë, ose për të konfirmuar ekzistencën ose veprimet e kartelit, një përjashtim i ngjashëm nga gjobat parashikohet për pjesëmarrësin e kartelit i cili është i pari që siguron prova të cilat i mundësojnë Autoritetit të provojë një shkelje serioze të Ligjit.

Në raste të tilla, kufizimi kryesor në zbatimin e lehtësimeve nga gjobat është kur pjesëmarrësi që kërkon lehtësim ka qenë një nxitës i drejtpërdrejtë ose tërthorazi i kartelit. Në raste të tjera, kur një pjesëmarrës në një kartel nuk kualifikohet plotësisht për përjashtim nga gjobat, Autoriteti mund të bie dakord për gjoba të reduktuara ndjeshëm në lidhje me një pjesëmarrës të kartelit i cili i siguron Autoritetit prova shtesë të vlefshme të cilat, kur përfshihen me provat e verifikuara tashmë gjatë hetimit nga Autoriteti, dëshmojnë të jetë vendimtare për përfundimin e ekzistencës ose operacioneve të kartelit.

Aspektet e tjera të lehtësimit përcaktohen në Udhëzimin Administrativ Nr. 7/2012 të Qeverisë së Republikës së Kosovës mbi kriteret për përjashtimin ose zvogëlimin e sanksionit administrativ në lidhje me Ligjin për Mbrojtjen e Konkurrencës (të ndryshuar). Në veçanti, kjo parashikon që lehtësimi nga gjobat duhet të kërkohet nga një pjesëmarrës i një karteli dhe nga ai pjesëmarrës duhet të plotësohen kushtet e mëposhtme:

- Bashkëpunim i plotë, i vazhdueshëm dhe i shpejtë me Autoritetin nga momenti i paraqitjes së kërkesës për lehtësim;
- Përfundimi i pjesëmarrjes në kartel nga data e njoftimit të kartelit tek Autoriteti (përveç nëse Autoriteti konsideron se pjesëmarrja e vazhdueshme është e nevojshme për zbatimin e suksesshëm të një inspektimi të paparalajmëruar sipas Neneve 39 dhe 41 të Ligjit, dhe
- Asnjë shkatërrim, falsifikim ose fshehje e provave të një karteli dhe asnjë publikim të faktit ose të përmbajtjes së qëllimit për të njoftuar kartelin tek Autoriteti.

Koncepti i *“bashkëpunimit të plotë, të vazhdueshëm dhe të shpejtë me Autoritetin”* shpjegohet më tej për të nënkuptuar që pjesëmarrësi i kartelit është i detyruar të paraqesë informacione të sakta, të plota dhe jo mashtruese. Kjo përfshin, në veçanti, informacionin dhe dëshminë përkatëse në lidhje me kartelin, të cilat tashmë janë në posedim të pjesëmarrësit ose në dispozicion të pjesëmarrësit. Ai gjithashtu kërkon disponueshmërinë e pjesëmarrësit për Autoritetin gjatë procedurës së hetimit për t'iu përgjigjur pa vonesë çdo kërkesë nga Autoriteti p.sh. në lidhje me personat e pranishëm gjatë operacioneve të kartelit (të tilla si punonjësit ose ish-punonjësit). Kjo kërkon gjithashtu që pjesëmarrësi të ruajë sekretin në lidhje me përfshirjen në hetim derisa të ketë arritur në pikën ku Autoriteti, para një seance dëgjimore zyrtare, të shpallë gjetjet e tij paraprake sipas Nenit 45 të Ligjit.

Një pjesëmarrës i kartelit duhet t'i sigurojë Autoritetit një deklaratë për të përfitur nga lehtësimi/falja. Kjo përfshin pranimin e pjesëmarrjes në kartel dhe detajet e funksionimit të tij. Gjatë hetimit, përjashtimi nga gjobat është kushtëzues dhe vendimi përfundimtar nga Autoriteti mbi përjashtimin kërkohet në fund të hetimit.

Për më tepër, Udhëzimi Administrativ Nr. 7/2012 përcakton kushtet në lidhje me uljen e gjobave sa i përket pjesëmarrësve të caktuar në një kartel. Ky udhëzim përcakton një procedurë të ngjashme që shtjellon këtë aspekt të nenit 60 të ligjit.

### ***Informacione të mëtejshme***

Për informacione të mëtejshme, shihni broshurat e tjera në serinë e AKK-së ***“Sigurimi i Përfitimeve nga Konkurrenca e Drjetë”*** dhe vizitoni faqen tonë në internet: <https://ak.rks-gov.net/>







Funded by  
the European Union



Kjo broshurë është përgatitur me ndihmën e Projektit të financuar nga BE: "Mbështetje e BE-së për Autoritetin Kosovar të Konkurrencës dhe Komisionin e Ndhmës Shtetërore" menaxhuar nga Zyra e BE-së në Kosovë dhe zbatuar nga një Konsorcium I B&S Europe

